



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA
OPSTINE SUVA REKA

04.02.19			
REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARË NË DORËZIM PRIMJEDAH RECEIVED			
Rresht Org. Org. Jedinica Org. Tipi	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlerë Vrednost Value
10	016	f397	2

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI, SPORT DHE MËRGATE

Me datë 04.02.2019

10-016-f397

Në mbështetje të nenit 4 nenit 13 lidhur me nenin 10, 11 dhe 13, të Rregullores MF-NR-04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë në Komunën e Suharekës, bën këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Komuna e Suharekës, përkatesisht Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë, përmes kësaj shkresë ju bën thirrje publike për aplikim të gjitha OJQ-ve, të regjistruara në Republiken e Kosovës që veprojnë brenda Komunës së Suharekës dhe që fushëveprimtari kanë kulturën, rininë dhe sportin, të aplikojnë për mbështetje financiare nga subvencionet e Drejtorisë për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë.

QËLLIMI;

Qëllimi i kësaj thirrjeje publike është subvencionimi dhe mbështetja financiare për klubet e sportit, OJQ-të rimore e kulturore për zhvillimin e aktiviteteve nga fushëveprimtaria e tyre.

- **Projektet nga fusha e kulturës:** Promovimet e vlerave të festivalave, koncerteve, shënimin e datave historike dhe kulturore, simpoziumet, ekspositave dhe promovimin e librave për botim.
- **Projektet në fushën e sportit:** Masovizimi i sportit për të rinjë.
- **Projektet në fushën e rinisë:** Promovimi i vullnetarizmit (aktivitete për shërbime të arsimit, evokim, kampanjë, menaxhment, aktivitete humanitare dhe ambientore).
- Edukim joformal
- Punësim i të rinjëve
- Fuqizim të organizatave rimore
- Infrastruktur për rini



SPECIFIKAT TË THIRRJES PUBLIKE

- Thirrja publike për aplikim hapet më **04.02.2019** dhe mbyllet më **19.02.2019**.
- Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së afatit për aplikim nuk do të pranohen
- Aplikacionet e pa kompletuara sipas kritereve të përcaktuara në këtë thirrje do të refuzohen
- Zbatimi i projekteve do të monitorohet nga personi përgjegjës i përcaktuar nga DKRSM.
- Mbështetësi finanziar, përkatesisht Komuna e Suharekës dhe përfituesi i donacionit do të lidhin kontratë me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.
- Me secilën OJQ që do të jetë përfituese e subvencionit do të nënshkruhet një kontratë përfituesit të mjeteve financiare dhe mbështetësit financiar.

Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e subvencionit;

- Aplikacioni, (sipas modelit të DKRSM -së); *të tjerhiqet në DKRSM*
- Projekt-propozimi, përfshirë, agjendën, aktivitetet, planifikimi dhe linja buxhetore në harmoni me qëllimin e projektit.
- Kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar nga OJQ-së,
- Certifikata me numër fiskal,
- Certifikata me numër të regjistrimit të biznesit
- Kopja e kartelës së xhirologaroisë në emrin e OJQ-së dhe kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar.
- Raporti finansiar i vitit paraprak 2018 (*kjo vlenë vetëm për klubet që kanë pranuar subvencione edhe në vitin e kaluar*).
- Deklaratë për mos financim të dyfishtë.

Mënyra e aplikimit;

- Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zarf të mbyllur,
- Brenda zarfit vendosen një kopje e të gjitha dokumentacionit origjinal të kërkuar,
- Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e pranimit në katin e parë në objektin e Komunës.

